



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY

Nr/Br.

876/19  
22.01.20

PSH .nr. 876/19

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Nuhi Paçarizi- Kryetar, z. Blerim Dina- Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE “MBB Construction” SH.P.K-Prizren, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: “I.P.N.EU” SH.P.K; “BEREQETI-ING” SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rregullimi dhe rrithimi i varrezave të Komunës së Prishtinës” me nr. të prok:616-1903-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Prishtinë, më datën: 13.01.2020, mori këtë:

### V E N D I M

**I. APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “MBB Construction” SH.P.K-Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rregullimi dhe rrithimi i varrezave të Komunës së Prishtinës” me nr. të prok:616-1903-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Prishtinë.

**II. VËRTETOHET**, njoftimi për dhënien e kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rregullimi dhe rrithimi i varrezave të Komunës së Prishtinës” me nr. të prok:616-1903-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Prishtinë.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

**V.** Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “MBB Construction” SH.P.K-Prizren, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

**VI.** Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE “MBB Construction” SH.P.K-Prizren, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 05.12.2019 me nr. 876/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rregullimi dhe rrithimi i varrezave të Komunës së Prishtinës” me nr. të prok:616-1903-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 7, 59, 60 si dhe nenin 61 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 10.12.2019, ka autorizuar eksperten profesionale të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja profesionale e prokurimit në raportin e dt: 27.12.2019, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim: OE ankues “MBB Construction “SH.P.K” -Prizren, pretendon se K.K ,Prishtinës nuk ka respektuar nenin 1 të LPP-së, sipas OE. ankues . Ekspertja thekson se qellim i këtij nenii është te sigurojnë mënyrë ma efikase ,më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike ,duke përcaktuar kushtet rregullat qe do te zbatohen , procedurat qe do te ndiqen ,te drejtat qe do te respektohen dhe detyrimi qe do te përbushen, andaj edhe pretendimi i OE. ankues është i pa bazuar, Sepse shpallja e fituesit e një OE .i cili ka ofertuar me çmim më të lirë të poentuar është ne harmoni me nenin 1 te këtij ligji. Andaj, Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pa bazuar.

OE ankues "MBB Construction "SH.P.K" -Prizren" pretendon se Kuvendi i Komunës së Prishtinës nuk ka respektuar nenin 7 të LPP-së, sipas OE ankues. Ekspertja thekson se qellim i këtij neni është trajtimi i barabartë dhe jo diskriminues i të gjithë ofertuesve ,andaj trajtimi i OE. ankues si i pasuksesshëm nuk është diskriminues, sepse me rastin e Ri-vlerësimit AK-së ju ka përbajtur pjesërisht vendimit me nr. 590/19 të OSHP-së lidhur me disa çmime që AK-së paraprakisht i ka konsideruar si çmime jo normalisht të ulëta kurse Paneli shqyrtues me vendimin e cekure më lart lenden e kishte kthyer lenden në rivlerësim duke konstatuar se kur kemi të bëjmë me çmim në bazë të poentimit dhe te këto raste minimizohet mundësia e manipulimit me çmime pasi që çmimet poentohen në bazë të përqindjes së dhënë për secilin artikull apo për grup artikujs. Andaj, Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pa bazuar .

OE ankues "MBB Construction "SH.P.K" -Prizren" pretendon se Kuvendi i Komunës së Prishtinës nuk ka respektuar nenin 59 të LPP-së, sipas OE. ankues . Ekspertja thekson se qellim i këtij neni është Ekzaminimi vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, fillimisht autoriteti kontraktues ka themeluar komision të R-vlerësimit i cili OE ankues e ka trajtuar si OE të pa pasuksesshëm dhe trajtimi si i pa suksesshëm Operatorin ekonomik ankues është në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Sa i përket pretendimit se OE. ankues lidhur me disa çmime jo normalisht të ulëta AK-së mbi bazën e atyre çmimeve e ka eliminuar herën e parë OE tani të shpallur fitues mirëpo pasi OSHP. Përkatësisht paneli shqyrtues e ka kthyer lenden në rivlerësim duke e potencuar ,duke konstatuar se kur kemi të bëjmë me çmim në bazë të poentimit dhe te këto raste minimizohet mundësia e manipulimit me çmime pasi që çmimet poentohen në bazë të përqindjes së dhënë për secilin artikull apo për grup artikujs . Gjithashtu AK-së nuk e ka paraparë ndonjë rrezik që kontrata mund edhe të mos implementohet sepse i njëjtë nuk e ka pa të arsyeshme të bëjë ndonjë hulumtim të tregut sepse të njëjtë janë të vetëdijshëm se vendimi i OSHP-së nuk ua ndalon të bëjnë hulumtim të tregut që nënkupton krahasimin e çmimit me objektin e kontratës, por ka vendosur duke e shpërblyer me konratë OE. me çmim më të lirë. Andaj, Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pabazuare.

OE ankues "MBB Construction "SH.P.K" -Prizren " pretendon se Kuvendi i Komunës së Prishtinës nuk ka respektuar nenin 60 të LPP-së, sipas OE ankues . Qëllimi i këtij neni është të përcaktohet kriteri për dhënie te konratës siç parashihet: 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët sipas poentimit. Ekspertja konstaton se kriteri për dhëni e konratës në njoftim për konratë dhe ne dosjen e tenderit ishte "tenderi i përgjegjshëm me çmimin me te ultë të poentuar" dhe nga ofertat e pranuara OE i shpërblyer me konratë ishte me çmim me të lirë te poentuar . Andaj, Ekspertja Konstaton se ky pretendim është i pa bazuar.

OE ankues "MBB Construction "SH.P.K" -Prizren " pretendon se Kuvendi i Komunës së Prishtinës nuk ka respektuar nenin 61 të LPP-së dhe „Rregulloren për Tenderët Jo –Normalisht të ulët (B57) sipas OE. ankues , Ekspertja sqaron se sa i përket pretendimit lidhur me nenin 61 i LPP-së dhe „Rregullorja për Tenderët Jo –Normalisht të ulët (B57). Konsideron se për ketë pikë pretenduese kemi vendimin e OSHP-së përkatësisht vendimin me nr 590/19 të datës 13.11.2019 i cili ndër të tjera sqaron se kur kemi kriterin çmimi më i lirë i poentuar AK-së duhet të eliminohen praktikat kur çmimin e një ofertuesi e krahason me çmimin e ofertuesit tjetër ,pasi që kriteri i tillë kërkon që çmimet e poentuara të bazohen në çmimin e ofertuar. E jo duke kahasuar çmimet me ofertuesit tjerë, sepse në rast kur kemi krasimën e çmimeve me ofertat të ndryshme me njëra –tjetrën atëherë kemi të bëjmë me kriterin çmimi më i ulët ku edhe gjene zbatim rregullorja për tenderët abnormalisht të ulët, apo kur përcaktojmë kriterin ekonomikisht më të favorshëm ku varësisht nga pikët maksimale përcaktohet fituesi ,pra te kriteri tenderi me çmim më të lirë të poentuar pavarësisht çmimit të ofertës për njësi sepse kemi të bëjmë me kontratë kornizë ku nuk kemi sasi indikative. Nga ky konstatim i panelit shqyrtues sqarohet se Rregullorja për tenderët abnormalisht të ulët gjen zbatim te kriteri „çmimi më i ulët por jo edhe te kriteri çmimi më i ulët i poentuar. Andaj mbi bazën e këtij shqyrtimi, Ekspertja konstaton se ky pretendim trajtohet si çështje e gjykuar “res judikata” sipas paragrafit 2.16 të nenit 105 të LPP-së dhe par. 3 të nenit 16 të Rregullores nr. 01/2017 së punës së OSHP-së, te bazuar në vendimin 590/19 të datës 13.11.2019 të nxjerr nga OSHP-ja përkatësisht Paneli Shqyrtues. Andaj , Ekspertja Konstaton se ky pretendim është i pa bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues që ankesën e lartpërmendor të operatorit ekonomik ankues HUHDHË POSHT si të PA BAZUARË (për arsyen që u cekën në secilin pretendim),dhe rekomandon që të mbetet ne fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues .

Autoriteti Kontraktues, me datë: 27.12.2019, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 27.12.2019, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 13.01.2020, pa praninë e palëve konform nenit 26.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e

dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për konratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin ankimoren të OE ankues "MBB Construction "SH.P.K" -Prizren se AK nuk ka respektuar nenin 1 të LPP-së, Paneli Shqyrtues konform ekspertes profesionale të prokurimit sqaron se qëllimi i këtij neni është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, duke përcaktuar kushtet rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimi që do të përmbrushen, andaj edhe pretendimi i OE ankues është i pa bazuar sepse OE i rekomanduar për konratë ka ofertuar me çmim më të lirë dhe është në harmoni me nenin 1 te këtij ligji. Andaj, ky pretendim është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "MBB Construction "SH.P.K" -Prizren" se AK nuk ka respektuar nenin 7 të LPP-së, Paneli Shqyrtues konform ekspertes profesionale të prokurimit thekson se qëllimi i këtij neni është trajtimi i barabartë dhe jo diskriminues i të gjithë ofertuesve, andaj trajtimi i OE ankues si i pasuksesshëm nuk është diskriminues sepse me rastin e Ri-vlerësimit, AK ju ka përbajtur pjesërisht vendimit PSH.nr.590/19 lidhur me disa çmime që AK-ja paraprakisht i ka konsideruar si çmime jo normalisht të ulëta, kurse Paneli shqyrtues me vendimin e cekur më lart, lëndën e kishte kthyer në rivlerësim duke konstatuar se kur kemi të bëjmë me çmim në bazë të poentimit minimizohet mundësia e manipulimit me çmime pasi që çmimet poentohen në bazë të përqindjes së dhënë për secilin artikull apo për grup artikuqsh. Andaj, Paneli Shqyrtues konform ekspertes profesionale të prokurimit konstaton se ky pretendim është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "MBB Construction" SH.P.K –Prizren se AK nuk ka respektuar nenin 59 të LPP-së, Paneli Shqyrtues konform ekspertes profesionale të prokurimit sqaron se qëllimi i këtij neni është ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve. Në këtë aspekt, fillimisht autoriteti kontraktues ka themeluar komision të Ri-vlerësimit, komisioni e ka vlerësuar OE ankues si OE të pa pasuksesshëm dhe trajtimi si i pa suksesshëm i OE ankues është në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Sa i përket pretendimit të OE ankues lidhur me disa çmime jo normalisht të ulëta të operatorit ekonomik të rekomanduar për konratë, ku AK mbi bazën e atyre çmimeve e ka eliminuar herën e parë ndërsa tani këtë

OE e ka shpallur fitues. Paneli Shqyrtues konform ekspertes profesionale të prokurimit sqaron se lënda më herët ishte kishte kthyer në rivlerësim duke potencuar se kur kemi të bëjmë me çmim në bazë të poentimit dhe te këto raste minimizohet mundësia e manipulimit me çmime pasi që çmimet poentohen në bazë të përqindjes së dhënë për secilin artikull apo për grup artikujsh. Gjithashtu, AK nuk e ka paraparë ndonjë rrezik që kontrata mund edhe të mos implementohet sepse i njëjtë nuk e ka pa të arsyeshme të bëjë ndonjë hulumtim të tregut sepse të njëjtë janë të vetëdijshëm se vendimi i OSHP-së nuk ua ndalon të bëjnë hulumtim të tregut që nënkupton krahasimin e çmimit me objektin e kontratës, por ka vodosur duke e shpërblyer me kontratë OE me çmim më të lirë. Andaj, Paneli Shqyrtues konform ekspertes profesionale të prokurimit konstaton se ky pretendim është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues “MBB Construction” SH.P.K -Prizren se AK nuk ka respektuar nenin 60 të LPP-së, Paneli Shqyrtues konform ekspertes profesionale të prokurimit sqaron se qëllimi i këtij neni është të përcaktohet kriteri për dhënie te kontratës siç parashihet: 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët sipas poentimit. Paneli Shqyrtues konform ekspertes profesionale të prokurimit konstaton se kriteri për dhënien e kontratës në njoftim për kontratë dhe në dosjen e tenderit ishte “tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ultë të poentuar” dhe nga ofertat e pranuara, OE i shpërblyer me kontratë ishte me çmim më të lirë të poentuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “MBB Construction” SH.P.K-Prizren se AK nuk ka respektuar nenin 61 të LPP-së dhe “Rregulloren për Tenderët Jo –Normalisht të ulët (B57)”, Paneli Shqyrtues konform ekspertes profesionale të prokurimit sqaron se sa i përket pretendimit lidhur me nenin 61 të LPP-së dhe “Rregullorja për Tenderët Jo –Normalisht të ulët (B57)”, për këtë pikë pretenduese kemi vendimin e OSHP-së përkatësisht vendimin me PSH.nr.590/19 të datës 13.11.2019 i cili ndër të tjera sqaron se kur kemi kriterin çmimi më i lirë i poentuar nga AK duhet të eliminohen praktikat kur çmimin e një ofertuesi e krahason me çmimin e ofertuesit tjeter, pasi që kriteri i tillë kërkon që çmimet e poentuara të bazohen në çmimin e ofertuar, e jo duke krahasuar çmimet me ofertuesit tjere, sepse në rast kur kemi krahasimin e çmimeve me ofertat të ndryshme me njëra -tjetrën, atëherë kemi të bëjmë me kriterin çmimi më i ulët ku edhe gjen zbatim rregullorja për tenderët abnormalisht të ulët. Apo, kur përcaktojmë kriterin ekonomikisht më të favorshëm ku varësish nga pikët maksimale përcaktohet fituesi, pra te kriteri tenderi me çmim më të lirë të poentuar pavarësish çmimit të ofertës për njësi sepse kemi të bëjmë me kontratë kornizë ku nuk kemi sasi indikative. Në këtë kuptim sqarohet se Rregullorja për tenderët abnormalisht të ulët gjen zbatim te kriteri “Çmimi më i ulët” por jo edhe te kriteri çmimi më i ulët i poentuar.

Paneli shqyrtues sqaron se ne rastin e kriterit çmimi më i lirë i poentuar gjithashstu minimizohet

mundësia e manipulimit me çmime pasi që sasia e realizuar (shpenzuar) nuk mund dhe nuk duhet të ndryshoj nga raportet sipas peshës se dhënë, p.sh nëse pesha është dhënë kategorive te artikujve apo shërbimeve duke u bazuar ne raportet sasiore/rëndësinë e kategorisë ndërmjet tyre, atëherë edhe shpenzimet për kategori duhet të ruajnë të njëjtin raport. Përfundimisht AK (njësia implementuese e kontratës) mbetet përgjegjëse që në secilin rast të dëshmoj ne mënyrë te qarte se sasia e porositur dhe shpenzuar është në harmoni me peshën e dhënë dhe me nevojat reale te AK-ës. kjo ne baze te interpretimit te KRPP-se te dates 10.12.2019 tek Pyetjet e shpeshta , pyetja nr.62.

Andaj, Paneli Shqyrtues konform ekspertes profesionale të prokurimit sqaron se ky pretendim trajtohet si çështje e gjykuar “res judikata” sipas paragrafit 2.16 të nenit 105 të LPP-së dhe par. 3 të nenit 16 të Rregullores nr. 01/2017 së punës së OSHP-së, te bazuar në vendimin 590/19 të datës 13.11.2019 të nxjerr nga OSHP-ja.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion, si dhe në sqarimet e ekspertes profesionale të prokurimit, vjen në përfundim se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave është bërë konform nenit 59 dhe 60 të LPP-së, duke rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik i cili ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli Shqyrtues vlerëson se AK me rastin e vlerësimit të ofertave ka pasur parasysh që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, sepse OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmime më të lira se sa ofertat e tjera të operatorëve ekonomik.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



#### Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK- Kuvendi Komunal Prishtinë
- 1x1 OE - “MBB Construction” SH.P.K-Prizren
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb-faqe të OSHP-së.